



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Shëndetësisë kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

- A2 Projekti i depos së barnave në vlerë 1,770,554€ me vonesa në realizim të punimeve.
- A3 Pranimi i 20 autoambulancave në vlerë 1,495,800€ pa përmbushje të plotë të specifikave teknike.
- A4 Furnizime në vlerë 778,946€ të pranuar vetëm me fletë-dërgesa pa hartim të raporteve të pranimit.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

UD Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, UD Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Shëndetësisë.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Shëndetësisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Shëndetësisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat që kërkojnë përmirësim të mëtutjeshëm janë prezantimi i drejtë i detyrimeve kontigjente, regjistrimi i plotë dhe klasifikimi i duhur i pasurive, si dhe prezantimi i drejtë i stoqeve.

Sa i përket pajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregullorët e zbatueshme, fokus më i madh duhet t'i kushtohet realizimit të projekteve brenda afateve të caktuara, menaxhimit dhe zbatimit të kontratave si dhe dokumentimit të procesit të pranimit të mallrave.

Ky raport ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime të reja.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A2 - Mosrespektim i afatit të përfundimit të punimeve sipas kontratës publike

#### Gjetja

Neni 17.2 i Kushteve të Veçanta të Kontratës përcakton se data e përfundimit të të gjitha punimeve do të jetë 180 ditë. Po ashtu, Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimi i Disponueshmërisë së Mjeteve, e shqyrtuar para nënshkrimit të kontratës, ka konfirmuar disponueshmërinë e mjeteve të mjaftueshme për realizimin e kontratës.

Ministria e Shëndetësisë ka zhvilluar procedurën e prokurimit për projektin “Renovimi i objektit të depos së barnave dhe ndërtimi i aneksit”, me kriter të vlerësimit “ekonomikisht më i favorshëm”, ku pesha e vlerësimit është përcaktuar si vijon: 70% çmimi i ofertuar, 20% plani dinamik dhe 10% garancioni i punimeve (1-10 vite).

Nga nëntë (9) operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, kontrata i është dhënë operatorit ekonomik i cili ka ofruar çmimin më të lartë në vlerë totale 1,770,554€, duke fituar përmes kombinimit të planit dinamik (180 ditë, nga 17.06.2025 deri më 17.12.2025) dhe garancionit 10-vjeçar.

Edhe përkundër përcaktimit të planit dinamik në kontratë, më 16.12.2025 operatori ekonomik fitues ka paraqitur kërkesë për rishikim të kushteve kontraktuale dhe zgjatje të afatit të planit dinamik, duke arsyetuar se Autoriteti Kontraktues nuk i ka përmbushur obligimet e tij kontraktuale.

Sipas të dhënave financiare, deri në fund të vitit 2025 janë realizuar shpenzime në vlerë prej 1,779,376 €, ku përfshihen edhe pagesat nga kontrata për punë shtesë, nga buxheti total i projektit prej 1,935,595 €. Megjithatë, pavarësisht kalimit të afatit të planifikuar për përfundimin e punimeve, projekti nuk është përmbyllur, duke rezultuar në vonesa të konsiderueshme në zbatimin e kontratës, përkundër peshës së përcaktuar në vlerësimin e ofertave lidhur me planin dinamik.

Shkaku i vonesave në realizim ishte mangësia në planifikimin dhe monitorimin e zbatimit të kontratës dhe mungesës së mekanizmave efektivë për sigurimin e respektimit të planit dinamik të ofertuar.

#### Ndikimi

Kërkesa për rishikim të kushteve kontraktuale duke zgjatur afatin kohor pas nënshkrimit të kontratës cënon parimin e barazisë në trajtimin e operatorëve ekonomikë dhe integritetin e procesit të prokurimit. Për me teper vonesat në përfundimin e projektit ndikojnë në bartjen e obligimeve financiare në vitin pasues.

#### Rekomandimi A2

Ministri duhet të siguroj zbatimin e plotë të mekanizmave të monitorimit në zbatimin e kontratave, duke siguruar respektim më rigoroz të planit dinamik të miratuar gjatë vlerësimit, në përputhje me planet buxhetore.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

**Çështja A3 - Pranimi i autoambulancave jashtë kushteve kontraktuale****Gjetja**

Specifikat teknike lidhur me “Certifikatat dhe pajtueshmërinë me standardet” me rastin e blerjes së autoambulancave kërkonin që automjeti, sistemet, pajisjet dhe aksesorët e tij të jenë në pajtim me standardin EN 1789:2020, si dhe të kenë deklaratën e konformitetit CE.

MSH kishte nënshkruar në dhjetor të vitit 2024 një kontratë publike kornizë (+/-30%) në vlerë prej 1,196,640€, me kohëzgjatje 36 muaj, për furnizimin me 16 autoambulanca.

Gjatë vitit 2025, MSH ishte furnizuar me 20 autoambulanca në vlerë totale 1,495,800€. Specifikat teknike përcaktonin autoambulancën si produkt përfundimtar, ndërsa operatori ekonomik kishte ofertuar automjete të tipit furgon, të cilat më pas ishin modifikuar në autoambulanca. Megjithatë, automjetet e pranuar nuk posedonin certifikatat e kërkuara sipas specifikimeve teknike. Komisioni pranues kishte konsideruar të mjaftueshëm vetëm aprovimin e lëshuar nga Qendra e Automjeteve të Kosovës, pa kryer verifikime shtesë për përputhshmërinë me standardet përkatëse.

Nga ekzaminimi i automjetit në Qendrën Urgjente në Prishtinë u evidentuan këto mospërputhje:

- Gjatësia e ndarjes së pacientit ishte kërkuar në specifika prej minimum 3100 mm, ndërsa ishte 2800 mm;
- Barela e Ambulances me rrota ne katalog ishte ofruar me dimensionet minimale 1930x600x210mm, ndërsa sipas matjeve ishte 1750mm;
- Stema, shënjimet dhe skema e ngjyrave nuk përmbushnin standardet e cilësisë dhe kishin filluar të dëmtohen para vënies në funksion;
- Kërkohej vizatimet 2D dhe 3D për planimetrinë e brendshme, ndërsa ndarja e brendshme ishte e papërfunduar dhe pa shënjime funksionale.

Dobësitë e evidentuara kanë ardhur si pasojë e mungesës së kontrolleve efektive në menaxhimin dhe monitorimin e zbatimit të kontratës publike kornizë, rrjedhimisht mos ushtrimi adekuat i përgjegjësive nga komisioni i pranimit.

**Ndikimi**

Pranimi i automjeteve të modifikuara nga furgon në autoambulancë pa certifikimet e kërkuara cenon përputhshmërinë me specifikat teknike dhe të sigurisë. Mospërputhjet e evidentuara gjatë ekzaminimit fizik tregojnë për pranimin e furnizimeve jo në përputhje me specifikimet teknike dhe kushteve të kontratës.

**Rekomandimi A3**

Ministri duhet të sigurojë që komisionet përkatëse të kryejn verifikim të detajuar të përputhshmërisë teknike dhe dokumentare të mallrave/shërbimeve të pranuar, duke përfshirë edhe verifikimin e certifikatave të detyrueshme sipas specifikimeve të kontratës dhe standardeve përkatëse.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A4 - Mungesa e raporteve të pranimit për mallrat e furnizuara**

**Gjetja** Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF për Shpenzimin e Parave Publike, neni 23 pika 1, dhe 3, përcaktojnë se pranimi i mallrave/shërbimeve duhet të bëhet nga zyrtari apo komisioni i autorizuar, i cili obligohet të hartojë raportin e pranimit dhe ta dorëzojë atë në Zyrën për Buxhet dhe Financa, duke zbatuar gjithashtu dispozitat për menaxhimin e pasurisë qeveritare.

Në katër (4) raste, në vlerë totale prej 778,946€, është konstatuar mungesa e raportit të pranimit nga komisioni përkatës për pranimin e mallit. Në këto raste, komisioni kishte nënshkruar vetëm fletë-dërgesat e Operatorëve Ekonomikë (OE), pa hartuar raport zyrtar të pranimit. Nga këto raste:

- tri (3) pagesa, në vlerë të përbashkët prej 759,400€, kanë të bëjnë me furnizim me barna;
- një (1) pagesë, në vlerë prej 19,546€, ka të bëjë me furnizim me inventar për burgje.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mosrespektimit të procedurave për pranimin e mallrave dhe mungesës së kontrollit adekuat nga zyrtarët përgjegjës për të siguruar që çdo pranim i mallit të dokumentohet me raport zyrtar nga komisioni përkatës.

**Ndikimi** Mungesa e raporteve të pranimit rrit rrezikun që mallrat të pranohen pa verifikim të plotë të sasisë dhe cilësisë, duke krijuar mundësi për gabime apo furnizime jo në përputhje me kontratën.

**Rekomandimi A4** Ministri përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm për të siguruar zbatimin e plotë të procedurave për pranimin e mallrave, duke siguruar që të dokumentohet procesi nga komisionet përkatëse me hartimin dhe nënshkrimin e raporteve të pranimit për çdo furnizim.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Stoqet

Në vitin 2025, MSh ka shpалosur stoqe në vlerë prej 7,042,607€, duke shënuar një rritje të ndjeshme prej 7% krahasuar me vitin paraprak. Pjesa dërrmuese e kësaj vlere i përket stokut farmaceutik.

#### Çështja A1 - Parregullësi në menaxhimin e stokut farmaceutik

<b>Gjetja</b>	<p>Rregullore MF - Nr. 01/2017, neni 6, Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare.</p> <p>Në regjistrat e stokut farmaceutik figuronin katër (4) artikuj në vlerë totale prej 95,520€, të cilëve u kishte kaluar afati i përdorimit. Për këta artikuj nuk ishte realizuar dalja në Sistemin e Menaxhimit të Stokut Farmaceutik (SMSF) si artikuj të skaduar. Si rezultat, kjo vlerë ishte përfshirë në raportin aktual të stoqeve të prezantuara në PFV. Për më tepër, në disa raste janë identifikuar mangësi në informatat e stokut farmaceutik, përfshirë sasi e regjistruar e produkteve pa çmim, dalje me sasi decimale dhe mospërputhje në datat e skadencës me datat reale të produktit. Megjithatë, këto mangësi nuk kanë ndikim material por ka ndikim në besueshmerinë e të dhënave lidhur me stokun.</p> <p>Këto gjetje tregojnë për dobësi në kontrollet e brendshme lidhur me menaxhimin e stokut farmaceutik, si dhe mungesë të integritetit dhe besueshmërisë së të dhënave në sistem.</p>
<b>Ndikimi</b>	<p>Moslargimi i artikujve të skaduar nga regjistrat ka rezultuar në mbivlerësimin e stokut farmaceutik dhe paraqitjen jo të saktë të tij në PFV, ndërsa evidentimi i daljes së produkteve pas skadimit tregon dobësi në kontrollet e brendshme për menaxhimin e stokut.</p>
<b>Rekomandimi A1</b>	<p>Ministri duhet të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme për menaxhimin e stokut farmaceutik, duke siguruar që produktet e skaduar të identifikohen, të largohen nga përdorimi dhe të mos përfshihen në stokun përfundimtar. Të bëhet harmonizimi dhe verifikimi periodik i të dhënave në sistem me gjendjen reale fizike, veçanërisht për datat e skadencës.</p>

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Sipas Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF), vlera e pasurive kapitale e paraqitur në fund të periudhës raportuese ishte 21,215,047€, vlera e pasurive jokapitale ishte 1,263,104€, ndërsa vlera e stoqeve ishte 7,042,607€

### Çështja A5 - Mangësi në regjistrimin dhe klasifikimin e pasurive në regjistrat e pasurisë

#### Gjetja

Rregullorja e Thesarit Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare, në nenet 12 dhe 13, sqaron procesin e regjistrimit kur një organizatë buxhetore blen apo ndërton pasuri jo financiare për organizata të tjera buxhetore, qoftë me financim të plotë apo bashkëfinancim. Pika 2 e këtyre neneve thekson se, në momentin kur pasuria jo financiare ka kaluar të gjitha procedurat dhe rregullat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese duhet të mbyllë llogarinë e investimeve në vijim, ndërsa pika 3 përcakton se organizata buxhetore pranuese duhet ta regjistrojë atë në regjistrat e saj të pasurisë jo financiare.

Po ashtu, neni 22 i Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcakton normat e zhvlerësimit dhe mënyrën e llogaritjes së tyre bazuar në natyrën e pasurisë.

Regjistri i pasurive kapitale ishte nënvlerësuar për 105,663€ si rezultat i mosregjistrimit të pasurive dhe klasifikimit të gabuar, ndërsa regjistri i pasurive jokapitale ishte mbivlerësuar për 1,650€ për shkak të mosaplikimit të zhvlerësimit në sistemin e-pasuria, si në vijim:

- Ministria e Shëndetësisë, në kuadër të projektit “Renovimi i ambulancës në Mogillë-Kllokot”, në vlerë prej 18,966€, nuk e kishte regjistruar projektin si pasuri në regjistrat kontabël të pasurive kapitale;
- Projekti “Sistemi i Mbikëqyrjes dhe Paralajmërimit të Sëmundjeve Ngjitëse”, i blerë në dhjetor 2023 në vlerë totale prej 185,779€, ishte regjistruar dhe trajtuar si pajisje e IT-së, duke iu aplikuar normat e zhvlerësimit për 3 vite. Megjithatë, nga natyra dhe funksioni i tij, ky sistem duhej të ishte klasifikuar si softuer (pasuri e paprekshme). Si rezultat i këtij klasifikimi të gabuar, vlera neto në libra (VNL) e pasurisë aktualisht është 61,926€, duke nënvlerësuar pasurinë për 86,697€;
- Po ashtu, janë evidentuar mangësi në aplikimin e normave të zhvlerësimit edhe për pasuritë nën 1,000€, ku pajisje të ndryshme të blera në vitet 2015 dhe 2017 vazhdojnë të paraqiten me vlerë neto në librat kontabël, pavarësisht se kanë tejkaluar dukshëm jetëgjatësinë e paraparë ekonomike. Vlera e tyre në regjister ishte 1,650€.

Kjo situatë ka ndodhur si rezultat i aplikimit të praktikës jo të duhur nga Ministria lidhur me evidentimin në regjistrin e pasurive të realizuara gjatë vitit. Ndërsa gabimi në klasifikim kishte ndodhur pasi pasuria ishte regjistruar duke u bazuar në kodet që MSH kishte përdorur gjatë certifikimit të lëndës.

#### Ndikimi

Mosrespektimi i kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurisë ka ndikuar që pasuria të mbetet jashtë regjistrave kontabël. Parregullsia në klasifikim dhe në aplikimin e normave të zhvlerësimit kanë rezultuar në nënvlerësim të pasurive dhe në paraqitje jo të saktë të vlerës së tyre në pasqyrat financiare.

**Rekomandimi A5** Ministri përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë e blera për organizatat përfituese të tjera, të trajtohen sipas kërkesave të rregullorës si dhe të barten të përfituesi përmes një procedure të shkruar dhe të dokumentuar. Po ashtu të rishikohet klasifikimi i pasurive ekzistuese, në mënyrë që ato të klasifikohen sipas natyrës reale të pasurisë dhe aplikimi i normave adekuate të zhvleresimit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

### 2.2.3 Detyrimet kontigjente

Detyrimet kontigjente të shpalosura në Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) për vitin 2025 ishin në vlerë totale prej 6,539,409€.

#### Çështja A6 - Mbivleresimi i detyrimeve kontigjente në PVF

##### Gjetja

Rregullorja Nr. 01/2017 për Raportimin Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, në nenet 17 dhe 18, përcakton se organizatat buxhetore duhet të raportojnë në Pasqyrat Financiare Vjetore të gjitha detyrimet kontigjente, si dhe të gjitha detyrimet e krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues, në mënyrë që pasqyrat financiare të paraqesin drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen financiare të institucionit.

Regjistri i detyrimeve kontigjente ishte mbivlerësuar për 73,189€:

- Në një (1) rast, detyrimi kontigjent i shpalosur në vlerë 14,347€ lidhur me propozimin për përmbarim ishte prapësuar në mars të vitit 2018, dhe nga kjo kohë nuk ka ndonjë dëshmi që rasti ka kaluar në Gjykatë;
- Në 6 (gjashtë) raste, në vlerë të përbashkët prej 37,462€, megjithëse të prezantuara në PVF, Ministria nuk posedonte dëshmi për ekzistimin e padive apo informata nga gjykatat për iniciimin e procedurave gjyqësore ndaj Ministrisë në këto raste;
- Një (1) rast, në vlerë prej 21,380€ kishte aktgjykim të plotfuqishëm dhe propozim për përmbarim, rrjedhimisht kjo shumë është dashur të shpalosej si detyrim i papaguar dhe jo si detyrim kontigjent.

Pas dorëzimit të Draft Raportit janë ofruar dëshmi të reja të cilat nuk ishin vënë në dispozicion gjatë fazës së terrenit. Pas vlerësimit të dëshmimeve, gjetja fillestare është modifikuar në pjesën e arsyetuar, ndërsa parregullsitë tjera mbeten si në gjendjen e konstatuar.

Këto pasaktësi kanë ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve efektive në procesin e përditësimit të të dhënave në regjistrin e detyrimeve kontigjente, si dhe mungesës së koordinimit të mjaftueshëm ndërmjet njësisë përgjegjëse për menaxhimin e kontesteve gjyqësore dhe njësisë financiare gjatë përgatitjes së PFV-ve.

##### Ndikimi

Kjo ka ndikuar në prezantimin jo të saktë të të dhënave në PFV duke ulur besueshmërinë dhe transparencën e informacionit financiar të paraqitur për palët e mundshme të interesit.

##### Rekomandimi A6

Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur mekanizmat e duhur të kontrollit në mënyrë që të bëhet një përditësim periodik i regjistrit të detyrimeve kontigjente, dhe të ofrohet një pamje e qartë dhe e drejtë e gjendjes financiare të organizatës.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>6</sup>	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>83,422,713</b>	<b>80,273,853</b>	<b>60,698,221</b>	<b>57,306,037</b>	<b>45,490,623</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	73,159,313	69,064,117	60,374,294	51,952,940	38,955,720
Financimi përmes huamarrjes	3,188,200	3,188,200	0	312,772	1,113,828
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	7,075,200	7,075,200	0	4,470,916	4,782,498
Donacionet vendore	0	138,996	136,907	399,867	129,150
Donacionet e jashtme	0	807,339	187,020	169,541	509,427

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 3,148,860€. Ky ndryshim është rezultat i zvogimit të buxhetit për shkak të lëvizjeve buxhetore dhe kursimeve sipas kategorive.

Në vitin 2025 Ministria ka shpenzuar 76% të buxhetit përfundimtar ose 60,703,377€. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të pakënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>83,422,713</b>	<b>80,273,853</b>	<b>60,698,221</b>	<b>57,306,037</b>	<b>45,490,623</b>
Pagat dhe mëditjet	16,552,536	17,686,482	17,668,452	16,218,601	13,031,527
Mallrat dhe shërbimet	35,296,324	35,248,705	31,075,802	27,006,275	19,452,122
Komunalitë	281,848	318,848	270,364	231,299	219,052
Subvencionet dhe transferet	2,813,805	2,774,574	2,774,570	3,369,272	4,978,161
Investimet Kapitale	28,478,200	24,245,243	8,909,033	10,480,590	7,809,761

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,133,946€, rritje kjo si rezultat i rritjes së njësisë së koeficientit të pagave për 0.5. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 100%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime, në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 47,619€ për shkak të kursimeve në kategori. Realizimi i kësaj kategorie ishte 88%.
- Buxheti final për komunal, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 37,000€. Realizimi i kësaj kategorie ishte 85%.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere, në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 39,231€. Realizimi i kësaj kategorie ishte 100%.
- Buxheti final për investime kapitale, në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 4,232,957€, si rezultat i shkurtimeve buxhetore në fund të vitit. Edhe përkundër këtij shkurtimi buxhetor, vetëm 37% e buxhetit ishte shpenzuar. Kjo ishte ndikuar nga vonesat në realizimin e projekteve ku nga 34 projektet e planifikuara, 14 nga këto nuk kishin fare progres financiar.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e planifikuara nga Ministria e Shëndetësisë në 2025 ishin 7,497,435€, ndërsa ishin realizuar në vlerë 4,119,887€. Ato kanë të bëjnë me gjobat nga inspektorati, licenca nga aktivitetet individuale dhe të lira, licenca për produkte medicinale, banderolat, participimet, shtija e shërbimeve dhe inspektimi higjenik sanitar.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>7,479,435</b>	<b>7,479,435</b>	<b>4,119,887</b>	<b>7,653,203</b>	<b>6,128,450</b>
Të hyrat jo tatimore	7,479,435	7,479,435	4,118,662	7,637,563	6,127,404
Të hyrat tjera	0	0	1,225	15,640	1,046

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 të Ministrisë ka rezultuar në tre (3) rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, të tre rekomandimet ishin zbatuar; siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3.

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të ndërmarrë masa për forcimin e kontroleve të brendshme, me qëllim sigurimin e zbatimit të plotë të kërkesave ligjore gjatë përgatitjes dhe vlerësimit të tenderëve.	Gjatë vitit 2025 nuk kemi hasur në ndonjë parregullsi.	I zbatuar
2.	Çështjet e përbashkëta	Ministri duhet të siguroj kontrole më të forta në përgatitjen e të dhënave në PVF, në mënyrë që ato të prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë.	Nuk kemi hasur në probleme lidhur me konsolidimin e informatave.	I zbatuar
3.	Detyrimet Kontigjente	Ministri duhet të ndërmarrë masa për të vlerësuar me saktësi mundësitë e realizimit të detyrimeve kontigjente dhe për të përcaktuar një vlerë financiare të mundshme, për të ofruar një pamje të qartë dhe të drejtë të gjendjes financiare të organizatës.	Është themeluar një grup punues, i cili ka vlerësuar pjesën dërrmuese të DK-së, aty ku ka pasur informata.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Mirlinda Beqiri, Udhëheqëse e ekipit



Jehona Krasniqi Rexha, Anëtare e ekipit



Xhevat Seferi, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mungesa e raporteve të pranimit për mallrat e furnizuara	Nuk pajtohem për shkak që ekzistojnë raportet e pranimit të të gjitha pagesat përveç rastit në vlerë prej 76,400.00 ku është përmirësuar gjatë periudhës audituese (dëshmitë i posedoni). Raportet e pranimit të mallit plotësojnë kriteret sipas legjislacionit në fuqi, ku përveç përshkrimit të produktit dhe elementeve të kontratës kanë të specifikuar edhe elemente shtesë ndërsa emërtimi i raportit teknikisht nuk ka pasur emrin Raport por emrin i produkteve dhe të njëjtat janë nënshkruar nga tre (3) anëtarët e komisionit pranues.	Edhe pse Ministria ka ofruar dëshmi shtesë gjatë procesit të auditimit, gjetja mbetet e pa ndryshuar. Fakti që dokumenti është siguruar/përmirësuar vetëm gjatë fazës së auditimit, konfirmon se ky shpenzim është ekzekutuar në mungesë të kontrollit fillestar dhe pa raport të rregullt pranimit, siç kërkohet me Nenin 23 të Rregullës Financiare Nr. 01/2013.
Mangësi në regjistrimin dhe klasifikimin e pasurive në regjistrat e pasurisë	Pajtohem pjesërisht me të gjeturën dhe nuk pajtohem me të gjeturën për regjistrim të pasurisë nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë për shkak që renovimi ka qenë pronë e Komunës. Sipas rregullores MF - Nr. 02/2013 PËR MENAXHIMIN E PASURISË JO FINANCIARE NË ORGANIZATAT BUXHETORE / Neni 15 Përmirësimet e pasurisë jo financiare pika 2. Përmirësimet do të regjistrohen në regjistrat përkatës si rritje e vlerës së pasurive jo financiare kapitale. Renovimi i Ambulancës në Mogillë-Kllokot në vlerë prej 18,966.00 euro në regjistra të pasurisë që do të duhej të regjistrohet nga Komuna përfituese për shkak që renovimi ka ndodhur brenda vitit fiskal dhe është bërë pranim-dorëzimi me komunën për renovimin në fjalë	Komenti i Ministrisë nuk e ndryshon gjetjen. Çështja e ngritur nuk ka të bëjë me pronësinë, por me trajtimin jo të duhur kontabël të transaksionit. Fakti që ky investim është financuar nga Ministria, krijon obligim që transaksioni të regjistrohet fillimisht në librat e saj për të siguruar gjurmën e plotë kontabël. Mos përfillja e procedurave të regjistrimit të investimit dhe mungesa e dokumentimit të bartjes kontabël nga ana e Ministrisë, ka bërë që kjo pasuri të ndikoj në nënvlerësimin e pasurive në pasqyra financiare. Gjetja A2 sipas draft raportit është reflektuar si A5 në raportin final.

REPUBLIKA E KOSOVËS Zyra Kombëtare e Auditimit NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
BATE/MAKROBILANSA BILANSA E PASQYRAT BUDZETI			
27-05-2026			
Nr. Prot. Org. Jedinica Org Unit	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Prot. No. Prot. no.	Nr. Faqe Pg. No. No. Pages
03	47	1089	2



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA E KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVSTVA-MINISTRY OF HEALTH	
Nr. Prot. Org. Jedinica Org Unit	Nr. Prot. Prot.No. Prot.No.
02	05-4450
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	Date: Datum: Date:
-2-	19/06/2026
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit


Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Shëndetësisë, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "DRAFT-RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË PËR VITIN 2025");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet tjera përveç çështjeve A2 dhe A4 të cilat janë të bashkëlidhura me komente në vijim;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

M. Z. Jahe Gecaj Ud. Sekretar i Përgjithshëm

Data: 19 qershor 2026, Prishtinë



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>7</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>8</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> (pajisje laboratorike të blera në vitin 2017 me jetëgjatësi të përcaktuar prej 5 vitesh; telefona mobil të blerë në vitin 2015 me jetëgjatësi 3 vjet; si dhe laptopë/kompjuterë të blerë në vitin 2015 me jetëgjatësi 4 vjet).
- <sup>6</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>7</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>8</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.